



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.389-2/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët– Skender Çoçaj kryesues, Bujar Muzaqi dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Avni Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komuna Istog, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 14.11.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.389/2025, e datës 04.11.2025, e parashtruar Avni Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komuna Istog, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 04.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.389/2025, nga Avni Gashi kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Istogut, nga radhët e Subjektit Politik AAK me seli në Prishtinë, dega në Istog, i cili pretendon se në disa vendvotime janë bërë shkelje nga komisionarët e vendvotimit, përkatësisht në këto vendvotimet: SH.F.M.U “Hysni Zajmi” në Vrellë, VV 0606/03, VV 0606/04 dhe VV 0606/05, si dhe në VV 0602, dhe SH.F.M.U “Trepça” në Banjë të Pejës, VV 0602/02, VV 0602/03, VV 0602/05, VV 0602/06, VV 0602/07 si dhe votat me postë.

Sipas parashtruesit të ankesës në rezultatet përfundimtare për asamble komunale në Istog, kandidati nga radhët e subjektit politik AAK, me numër rendor 5, rezulton të ketë marrë 97 vota. Ndërsa sipas gjendjes faktike që është paraqitur në rezultatet e shpallura nga KQZ, si rezultate përfundimtarë për Asamble Komunale në Istog, rezulton që në disa qendra votimi dhe vendvotime, i njëjti ka më pak vota edhe pse votuesit e tij, kanë deklaruar me shkrim që kanë votuar në këto vendvotime dhe se në bazë të deklaratave të tyre, numri i votave do të duhej të ishte më i madh.

Në Qendrën e votimit Shkolla Fillore "Hysni Zajmi" në Vrellë: Vendvotimi 0606/03 sipas rezultateve të KQZ janë të publikuar gjithsejtë 21 vota, kurse i njëjti posedon 26 deklarata të votuesve të cilët pohojnë se kanë votuar numrin 5. Po ashtu në Vendvotimin 0606/04, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuar gjithsejtë 10 vota, kurse i njëjti posedon gjithsej 18 deklarata të votuesve, Vendvotimi 0606/05, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsejtë 44 vota, ndërsa deklarata e komisionerit të AAK-së Sadeta Vuthaj dhe deklarata nga Vëzhguesi i LDK-se Hamdi Zeqiraj, i njëjti pretendon se ka marrë 50 vota.

Në Qendrën e votimit 0602, SH, F.M.U "Trepça" Banjë e Pejës, në Vendvotimin 0602/02, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara 0 vota, kurse sipas deklaratës në këtë vendvotim duhet të ketë 1 votë. Në Vendvotimin 0602/03, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsejtë 0 (zero) vota, kurse sipas deklaratave duhet ti ketë 2 vota. Në vendvotimin 0602/05, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsejtë 6 vota, kurse sipas deklaratave duhet të ketë 7 vota. Në vendvotimin 0602/06, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuar gjithsejtë 3 vota, kurse i njëjti duhet ti ketë 6 vota. Në vendvotimin 0602/07, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuar gjithsejtë 2 vota, kurse i njëjti duhet ti ketë 3 vota.

Më tej në ankesë pretendon se nga votimi me postë sipas rezultateve nga KQZ janë publikuar gjithsej 14 vota, kurse sipas dëshmisë së familjarëve dhe miqve i njëjti ka gjithsejtë 21 vota në total: 9 familjar/miq nga Gjermania, 6 familjar/miq nga Zvicra, 5 familjar/miq nga Austria, 1 mik nga Brukseli.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur deklarata të votuesve dhe komisionerëve, Kërkon që të bëhet rinumërimi i votave.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, sqaron se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, NI-.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV.

KQZ, gjithashtu ju njoftoj se, procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar.

Më tej në përgjigje theksohet se më datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime. Në faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të

ndara në kuti sipas komunave të votuesve. (Shih të bashkangjitur Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime),

Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës: 1 7, Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR.

Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr.14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht, në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike,

Pala ankuese, ndër të tjera, ka pretenduar se disa nga familjarët kanë votuar për të mirëpo, sipas tij mungojnë votat e tyre. Ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe, në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, dhe po ashtu në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit.

Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese i cili mbështetet në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe familjareve të tij, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1,3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit.

Parashtruesi i ankesës, nuk ka ofruar dëshmi të çarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LPZ-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, dhe pretendimet e ankuesit nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritet e ankuesit për të marr më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara.

Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, po ashtu nuk ka bashkëngjitur prova relevante, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e saj. Pra, nuk ka bashkëngjitur libër të votimit në vendvotim dhe QKN, formularë, ose prova të tjera që do të mund të mbështesnin pretendimet e saj.

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor, (duke përfshirë kamerat e sigurisë, Librat e Votimit dhe Formularët) gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

PZAP, pas shqyrtimit të kësaj anese, me vendimin ZL.A.nr.389/2025 të datës 05.11.2025, ka refuzuar ankesën e Avni Gashi, kandidat për asamble komunale në Komunën e Istogut, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), .

Në procedurë ankimore, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin A.A.nr.111/2025 të datës 11.11.2021, ka aprovuar ankesën e Avni Gashi, kandidat për asamble komunale nga radhët e subjektit politik AAK, Komuna Istog, dhe ka anuluar vendimin e PZAP-it ZL.A.nr.389/2025 të datës 05.11.2025, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje në PZAP.

Me rastin e rivendosjes sipas ankesës së lartë përmendur të ankuesit Avni Gashi, duke vepruar në tërësi sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata Supreme e Kosovës, në aktvendimin A.A.nr.111/2025 i datës 11.11.2025, dhe me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të

gjendjes faktike, në këtë procedurë të rivendosjes, PZAP-i mblodhi dhe i hetoi prova nga KQZ, analizoi dhe vlerësoi të gjitha provat nga shkresat e lëndës, dhe nga gjitha shkresat dhe provat e gjetura erdhi ne përfundim se:

- Ankesa është e pa bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoj se pretendimet e kandidatit për Asamble Komunale nga subjekti politik i AAK Avni Gashi dega Istog, janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe as pas hetimeve të bëra nga PZAP nuk është arritur që të vërtetohen se ka pasur parregullësi në qendra të votimit të cekura në ankesë dhe nga fletëvotimet e arritura me postë.

Kandidati në fjalë nuk ka sjell prova që dëshmojnë numrin e saktë të votave që i mungojnë dhe nuk e ka provuar me dëshmi të mjaftueshme, ndërsa provat e bashkangjitura në ankesë dhe atë deklaratat votueseve të tij të cilët kanë deklaruar me shkrim që kanë votuar në këto vendvotime të njëjtat nuk janë prova të sigurta dhe të besueshme dhe se këto prova nuk e identifikojnë votuesin, prandaj edhe nuk mund të vërtetohet se personat qe kanë dhënë deklarate kanë votuar për kandidatin Avni Gashi, pra asnjë fletëvotim nuk e identifikon votuesin duke qenë se votimi është i fshehtë.

Paneli ka ndërmarrë hetim ashtu që më datë 12.11.2025 ka kërkuar nga KQZ, materialin zgjedhor lidhur me pretendimet ankimore të kandidatit Avni Gashi, dhe se njëjta ka siguruar materialin: Formularët e Rezultateve për kandidat, Librin e Votimit (Libri i shënimeve në vendvotim), si dhe Librin e Evidencës në QNR. Mirëpo, nga provat e siguruara paneli nuk mundi të vërtetoj ndonjë parregullsi apo vërejtje gjatë votimit, numërimit apo mos regjistrim të votës, si dhe nga fletëvotimet e arritura me postë, pasi që nuk ka mospërputhshmëri të rezultateve.

Pretendimi ankimor i kandidatit nga radhët e subjektit politik AAK, me numër rendor 5, Avni Gashi, se i njëjti ka fituar 97 vota, dhe se nuk i janë regjistruar votat e familjareve të tij, të cilët kanë votuar në këto qendra, për çka ka bashkangjitur edhe prova – deklarata, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që, nuk ka ofruar prova të qarta dhe bindëse se në këto qendra të votimit kanë votuar familjarët e tij, njeherit Paneli pas hetimit ka konstatuar se nga hetimi i bërë rezulton se i njëjti të ketë marrë 97 vota, dhe se këto vota nuk mund të dihet se nga cili votues është votuar.

Paneli ka vlerësuar edhe pretendimet se në vendvotime janë bërë shkelje nga komisionarët e vendvotimit, por këto pretendime i ka vlerësuar si të pa bazuara, ngase numërimi për kandidatët asambleist bëhet në vetëm në Qendrën Komunale të Numërimit, numërimi bëhet në mënyrë transparente ashtu siç është paraparë me nenin 15 dhe 16 dhe 17 të Rregullores Zgjedhore 16/2024 dhe Procedurës së paraparë të Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për zgjedhjet Lokale 2025, numërimi bëhet në Qendrën e Numërimit duke kaluar nëpërmes sistemit digjital, ku më këtë rast çdo fletëvotim në të dy anët shfaqet ne ekran të cilën e shohin të gjithë personat e pranishëm, komisionarët, vëzhguesit e subjekteve politike dhe mediat e akredituara ku dhe mund të bëhen vërejtje lidhur me votat nëse duhet të konsiderohet e vlefshme apo jo.

Në vendvotimet SH.F.M.U "Hysni Zajmi" në Vrellë, Librin e Votimit dhe në Formularët e Rezultateve për kandidat në vendvotime: VV 0606/03, VV 0606/04 dhe VV 0606/05, si dhe në QV 0602, SH.F.M.U "Trepça" në Banjë të Pejës, Librin e Votimit dhe në Formularët e Rezultateve për kandidat në vendvotimet VV 0602/02, VV 0602/03, VV 0602/05, VV 0602/06, VV 0602/07 si dhe votat me postë VP06/07 Libri i Evidencës në QNR dhe në Formularin e Rezultateve të kandidatëve, paneli pas hetimit nuk ka gjetur se kishte ndonjë vërejtje apo kundërshtim apo mos regjistrim të votave.

Duhet cekur se lidhur me deklaratat e votuesve dhe fshehtësisë së votimit, është krijuar tashmë praktika gjyqësore nga se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj AA.nr.61/2025 të datës 24.03.2025 kishte konstatuar se: *"deklaratat e votuesve të cilët pretendojnë se kanë votuar një kandidat të caktuar nuk mund të merren si prova të bazuara për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesit përkatës të kenë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit"*.

Bazuar në të lartcekurat paneli vlerësoj se bazuar në nenin 117.3 të LZP-së përcaktohet se: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*. Sipas kësaj dispozite ligjore parashtuesi i ankesës duhet të sjell dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet e tij, por që me rastin e parashtimit të ankesës nga Avni Gashi, kandidat për asamblë komunale e subjektit politik AAK, nuk ka sjell dëshmi që vërtetohen pretendimet e tij, ndërsa pretendimet e tilla nuk kanë gjete mbështetje edhe pas hetimit dhe provave të siguruara nga PZAP, andaj pretendimi se duhet të ketë rinumërim të votave mbetet vetëm i natyrës deklarative dhe se nuk është mbështetur me asnjë provë që do të dëshmonte pretendimet ankimore.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *"PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht"* dhe Neni 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *"PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë"*, andaj vlerësoj se ankesa e lartë përmendur nuk është e bazuar dhe të njëjtën vendosi që ta refuzoj si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZLAnr.389-2/2025 më datën 14.11.2025


Kryesuesi i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME



A.A.nr.120/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Nenad Lazic, anëtar të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së ankuesit: Avni Gashi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, nga subjekti politik: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shpalljen e rezultateve për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.389-2/2025, të datës 14.11.2025, në seancën e mbajtur më datë 19.11.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET ankesa e parashtruar nga ankuesi: Avni Gashi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, nga subjekti politik: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.389-2/2025, të datës 14.11.2025 dhe çështja i kthehet Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) në rivendosje.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.389-2/2025, të datës 14.11.2025, është vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa ZL.Anr.389/2025, e datës 04.11.2025, e parashtruar Avni Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komuna Istog, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, Dega në Istog, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

Kundër këtij vendimi ankesë në Gjykatën Supreme, ka parashtruar Avni Gashi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, nga subjekti politik: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: aplikimit të gabuar të së drejtës material, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike



dhe moszbatim të gjetjeve në aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, duke propozuar nga Gjykata Supreme e Kosovës që të: aprovojë ankesën si të bazuar, të anulohet vendimi i PZAP-it, ZL.Anr.389-2/2025, të datës 14.11.2025, të urdhërohet PZAP që të lejoj rinumërimin e votave dhe të obligohet KQZ që të bëjë verifikimin e materialit zgjedhor dhe të urdhërohet rinumërimi i votave në vendvotimet në shkollën fillore SH.F.M.U “Hysni Zajmi”, 0606/03, VV 0606/04 dhe VV 0606/05, si dhe SH.F.M.U “Trepça” në Banjë Pejës, VV 0602/02, VV 0602/03, VV 0602/05, VV 0602/06, VV 0602/07 si dhe rishikimin e votave me postë për komunën e Istogut, korrigjojë rezultatin përfundimtar në përputhje me numrin real të votave.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe propozon që ankesa e parashtruar nga kandidati për kuvend komunale në Komunën e Istogut, Avni Gashi, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi i kontestuar i PZAP-it, ZL.Anr.389-2/2025, të datës 14.11.2025, të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 04.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZLAnr.389/2025, nga Avni Gashi kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Istogut nga radhët e Subjektit Politik AAK me seli në Prishtinë, Dega në Istog, i cili pretendon se në disa vendvotime janë bërë shkelje nga komisionarët e vendvotimit, përkatësisht në këto vendvotime: SH.F.M.U “Hysni Zajmi” në Vrellë, VV 0606/03, VV 0606/04 dhe VV 0606/05, si dhe në VV 0602, dhe SH.F.M.U “Trepça” në Banjë Pejës, VV 0602/02, VV 0602/03, VV 0602/05, VV 0602/06, VV 0602/07 si dhe votat me postë, duke kërkuar më saktësisht si në ankesë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e kandidatit Avni Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Istogut nga radhët e Subjektit Politik AAK me seli në Prishtinë, Dega në Istog.

Pas pranimi të përgjigjes në ankesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZL.Anr.389/2025, të datës 05.11.2025, me të cilën e ka refuzuar ankesën e kandidatit Avni Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Istogut nga radhët e Subjektit Politik AAK me seli në Prishtinë - Dega në Istog, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit.

Kundër këtij aktvendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës, ankesë ka ushtruar Avni Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Istogut nga radhët e Subjektit Politik AAK me seli në Prishtinë - Dega në Istog, duke e kontestuar në tërësi aktvendimin e PZAP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas ankesës së ankuesit Avni Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Istogut nga radhët e Subjektit Politik AAK me seli në Prishtinë, Dega në Istog, e ka pranuar ankesën si të bazuar dhe e ka kthyer çështjen në rivendosje në PZAP.



Pas pranimit të aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZL.Anr.389-2/2025, të datës 14.11.2025, me të cilin përsëri e ka refuzuar ankesën e kandidatit Avni Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Istogut nga radhët e Subjektit Politik AAK me seli në Prishtinë, Dega në Istog, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoj se pretendimet e kandidatit për Asamble Komunale nga subjekti politik i AAK Avni Gashi dega Istog, janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe as pas hetimeve të bëra nga PZAP nuk është arritur që të vërtetohen se ka pasur parregullsi në qendra të votimit të cekura në ankesë dhe nga fletëvotimet e arritura me postë.

Ka shtuar se kandidati në fjalë nuk ka sjell prova që dëshmojnë numrin e saktë të votave që i mungojnë dhe nuk e ka provuar me dëshmi të mjaftueshme, ndërsa provat e bashkangjitura në ankesë dhe atë deklaratat votueseve të tij të cilët kanë deklaruar me shkrim që kanë votuar në këto vendvotime të njëjtat nuk janë prova të sigurta dhe të besueshme dhe se këto prova nuk e identifikojnë votuesin, prandaj edhe nuk mund të vërtetohet se personat që kanë dhënë deklarate kanë votuar për kandidatin Avni Gashi, pra asnjë fletëvotim nuk e identifikon votuesin duke qenë se votimi është i fshehtë.

Paneli ka ndërmarrë hetim ashtu që më datë 12.11.2025 ka kërkuar nga KQZ, materialin zgjedhor lidhur me pretendimet ankimore të kandidatit Avni Gashi, dhe se njëjta ka siguruar materialin: Formularët e Rezultateve për kandidat, Librin e Votimit (Libri i shënimeve në vendvotim), si dhe Librin e Evidencës në QNR. Mirëpo, nga provat e siguruara paneli nuk mundi të vërtetoj ndonjë parregullsi apo vërejtje gjatë votimit, numërimit apo mos regjistrim të votës, si dhe nga fletëvotimet e arritura me postë, pasi që nuk ka mospërputhshmëri të rezultateve.

Pretendimi ankimor i kandidatit nga radhët e subjektit politik AAK, me numër rendor 5, Avni Gashi, se i njëjti ka fituar 97 vota, dhe se nuk i janë regjistruar votat e familjareve të tij, të cilët kanë votuar në këto qendra, për çka ka bashkangjitur edhe prova deklarata, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që, nuk ka ofruar prova të qarta dhe bindëse se në këto qendra të votimit kanë votuar familjarët e tij, njeherit Paneli pas hetimit ka konstatuar se nga hetimi i bërë rezultoi se i njëjti të ketë marrë 97 vota, dhe se këto vota nuk mund të dihet se nga cili votues është votuar.

Paneli ka vlerësuar edhe pretendimet se në vendvotime janë bërë shkelje nga komisionarët e vendvotimit, por këto pretendime i ka vlerësuar si të pa bazuara, ngase numërimi për kandidatët asambleist bëhet në vetëm në Qendrën Komunale të Numërimit, numërimi bëhet në mënyrë transparente ashtu siç është paraparë me nenin 15 dhe 16 dhe 17 të Rregullores Zgjedhore 16/2024 dhe Procedurës së paraparë të Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për zgjedhjet Lokale 2025, numërimi bëhet në Qendrën e Numërimit duke kaluar nëpërmes sistemit digjital, ku më këtë rast çdo fletëvotim në të dy anët shfaqet në ekran të cilën e shohin të gjithë personat e pranishëm, komisionarët, vëzhguesit e subjekteve politike dhe mediat e akredituara ku dhe mund të bëhen vërejtje lidhur me votat nëse duhet të konsiderohet e vlefshme apo jo.



Në vendvotimet SH.F.M.U "Hysni Zajmi" në Vrellë, Librin e Votimit dhe në Formularët e Rezultateve për kandidat në vendvotime: VV 0606/03, VV 0606/04 dhe VV 0606/05, si dhe në QV 0602, SH.F.M.U "Trepça" në Banjë të Pejës, Librin e Votimit dhe në Formularët e Rezultateve për kandidat në vendvotimet VV 0602/02, VV 0602/03, VV 0602/05, VV 0602/06, VV 0602/07 si dhe votat me postë VP06/07 Libri i Evidencës në QNR dhe në Formularin e Rezultateve të kandidatëve, paneli pas hetimit nuk ka gjetur se kishte ndonjë vërejtje apo kundërshtim apo mos regjistrim të votave.

Duhet cekur se lidhur me deklaratat e votuesve dhe fshehtësisë së votimit, është krijuar tashmë praktika gjyqësore nga se Gjykata Supreme me aktgjykimin e saj AA.nr.61/2025 të datës 24.03.2025 kishte konstatuar se: "deklaratat e votuesve të cilët pretendojnë se kanë votuar një kandidat të caktuar nuk mund të merren si prova të bazuara për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesit përkatës të kenë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit".

Bazuar në të lartcekurat paneli vlerësoj se bazuar në nenin 117.3 të LZP-së përcaktohet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse". Sipas kësaj dispozite ligjore parashtruesi i ankesës duhet të sjell dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet e tij, por që me rastin e parashtrimit të ankesës nga Avni Gashi, kandidat për asamble komunale e subjektit politik AAK, nuk ka sjell dëshmi që vërtetohen pretendimet e tij, ndërsa pretendimet e tilla nuk kanë gjetë mbështetje edhe pas hetimit dhe provave të siguruara nga PZAP, andaj pretendimi se duhet të ketë rinumërim të votave mbetet vetëm i natyrës deklarative dhe se nuk është mbështetur me asnjë provë që do të dëshmonte pretendimet ankimore.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se "PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht dhe Neni 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: "PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë", andaj vlerësoj se ankesa e lartë përmendur nuk është e bazuar dhe të njëjtën vendosi që ta refuzoj si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), lidhur me refuzimin e ankesës së parashtruar nga Avni Gashi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se vendimi i PZAP-së është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, të zbatueshëm sipas Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale, si dhe në kundërshtim me Rregulloren nr. 01/2025 të PZAP-së për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave. Si rezultat i kësaj, nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, ndërkohë që është aplikuar në mënyrë të gabuar edhe e drejta materiale, duke u refuzuar ankesa e parashtruar nga kandidati për kuvend komunal.



Gjykata Supreme vlerëson se, në rastin konkret, PZAP ka vendosur gabimisht, me refuzimin e ankesës së parashtruar nga kandidati për kuvend komunal, për faktin se: PZAP-i nuk ka dhënë arsye të qëndrueshme dhe bindëse në raport me pretendimet ankimore; madje, arsyet e dhëna janë kundërthënëse në vetvete, pasi në njërën anë potencohet se ankesa është refuzuar për mungesë dëshmish, ndërsa në anën tjetër thuhet se dëshmitë e dorëzuara nga ankuesi nuk mund të vërtetojnë se votuesit përkatës kanë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar, për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit. Një arsyetim i tillë është i paqëndrueshëm dhe i pamjaftueshëm, pasi nuk është dhënë përgjigje për secilin pretendim, ndërsa pretendimeve kryesore u është dhënë përgjigje pa u kryer hetim fare. Nuk mund të anashkalohet fakti se dëshmitë që gjenden në dosjen e lëndës janë të vetmet që pala ka mundur të sigurojë, për shkak të pamundësisë për qasje në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR).

Gjykata vlerëson gjithashtu se arsyetimi i PZAP-it në lidhje me përgjigjen e KQZ-së, sipas së cilës deponimi i dëshmimeve nga ana e ankuesit cenon fshehtësinë e votës, nuk qëndron. Sipas nenit 4 pika 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) përcaktohet se: *“Liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjëse për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mosvotim.”*

Në këtë kuptim, me rastin e deponimit të dëshmimeve, si formularë të deklarimit vullnetar të personave si dëshmitarë, nuk cenohet as liria dhe as fshehtësia e votës. Nga interpretimi i dispozitës në fjalë, votuesi, me vullnetin e tij të lirë, mund të zbulojë votën e vet pas procesit të votimit, por askush nuk mund ta detyrojë ta bëjë këtë kundër dëshirës së tij. Kur kësaj i shtohet fakti se mënyra e vetme për hetimin e parregullsive të pretenduara në Qendrën e Numërimit është hapja e kutive të votimit, del se dëshmitë e vetme që pala mund të sigurojë janë deklaratat vullnetare të qytetarëve. Qytetarët që kanë nënshkruar formularët përkatës i kanë deponuar ato në institucionin kompetent - PZAP, që garanton integritetin e procesit zgjedhor, dhe nuk i kanë bërë publike. Prandaj, për qëllime të hetimit dhe verifikimit të pretendimeve, si dhe për ruajtjen e integritetit të procesit zgjedhor, këto deklaratat paraqesin dëshmi të vlefshme për procedim dhe hetim të mëtejshëm.

Duke u bazuar në pretendimet e paraqitura në ankesë, gjykata vëren se ankuesi ka ofruar të dhëna të detajuara për disa qendra votimi dhe vendvotime konkrete, duke identifikuar mospërputhje mes numrit të votave të publikuara nga KQZ dhe numrit të deklaratave të votuesve që pretendojnë se kanë votuar për të. Në secilën prej këtyre qendrave, sipas dokumentacionit të dorëzuar, numri i deklaratave të votuesve është dukshëm më i lartë se numri i votave të regjistruara për kandidatin, gjë që ngre dyshime të arsyeshme për pasaktësi në numërim dhe justifikon nevojën për verifikim përmes rinumërimit.

Si rrjedhojë, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se PZAP, me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit, nuk ka vepruar sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe nuk ka vepruar në pajtim me nenin 117 [Procedurat e PZAP-së] paragrafi 4 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet se: *“PZAP-ja mund të urdhërojë rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi, si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën e parashtruar.”*



Po ashtu, nuk është respektuar neni 15 [Zhvillimi i Hetimeve të Materialit Zgjedhor] paragrafi 3 pika 3.1 i Rregullores nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, sipas të cilit: *“Duke u bazuar në ankesat e paraqitura për shkeljet e supozuara në QNR, QKN, PZAP-i mund të kryejë këto hetime: 3.1. Hetimin e kutisë së votimit.”*

Gjykata thekson se, në kuptimin e nenit 117 paragrafi 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ekzistenca e dyshimeve të bazuara për pasaktësi në procesin e numërimit përbën arsye të mjaftueshme për të urdhëruar hapjen e kutive të votimit dhe rinumërimin e tyre. Për më tepër, deklaratat e votuesve janë dhënë në mënyrë vullnetare, të identifikuara me emër, mbiemër, numër personal dhe nënshkrim, dhe janë dorëzuar vetëm në institucionin kompetent - PZAP, pa u bërë publike. Këto deklarata, përbëjnë prova të pranueshme me vlerë juridike, të cilat kërkojnë shqyrtim dhe vlerësim përmbajtjesor nga PZAP.

Për pasojë, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se rinumërimi i votave në vendvotimet e identifikuara në ankesë është i domosdoshëm për të vërtetuar rezultatin e saktë të zgjedhjeve dhe për të garantuar integritetin e procesit zgjedhor, në përputhje me parimin e besueshmërisë së zgjedhjeve të sanksionuar në nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Të metat e mësipërme janë të natyrës së tillë që e bëjnë të pamundur që Gjykata Supreme e Kosovës të vendosë ndryshe, për faktin se sipas nenit 117 të LZP-së, është kompetencë e PZAP-it që, gjatë vendosjes për një ankesë, të shqyrtojë dhe hetojë të gjitha dëshmitë relevante. Në rastin konkret, PZAP është dashur të sigurojë dhe të hetojë materialin zgjedhor, veçanërisht kutitë e votimit, me qëllim që të vërtetohen dëshmitë që paraqesin prova të rëndësishme për të vlerësuar ecurinë e procesit zgjedhor në secilën qendër votimi të pretenduar.

Gjykata Supreme e Kosovës, sqaron faktin se hapja e kutive nga paneli hetues i caktuar nga ana e PZAP-së, nuk e cenon integritetin e votës dhe nuk e zbulon fshehtësinë e votuesit, sepse detyra e panelit hetues është vetëm të konstatoj se sa vota gjenden në kutitë e votimit për ankuesin, e për të cilat vendvotime ka ofruar dëshmi - deklarata të votuesve, por në asnjë rrethanë paneli i hetimit nuk identifikon me emër dhe mbiemër se cilët votues kanë votuar kandidatin dhe cilët jo, sepse kjo gjë do të ishte objektivisht e pamundur në çdo rrethanë, duke pasqyruar se fletëvotimi përmban të dhënat vetëm sa i përket listës së kandidatëve dhe jo edhe të votuesve.

Në rivendosje, PZAP, udhëzohet që të shqyrtojë edhe njëherë udhëzimet e dhëna nga kjo gjykatë, pretendimet ankimore të ankuesit, provat e deponuara dhe të procedojë tutje në hetimin e këtyre pretendimeve përkatëse që të sigurojë që mos të cenohet integriteti i procesit zgjedhor dhe secila votë të shkojë në destinimin e synuar dhe mos të ketë devijim të vullnetit të qytetarëve.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

A.A.nr.120/2025, më datë 19.11.2025.



Kryetar i kolegjit,
Qerim Ademaj
Republika e Kosovës
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE

Dunëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-120/2025

FLETËDËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

PZAP - PRISATINE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi I sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqijt, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokusajo dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më 21.11.2025 201 në ora 10:30
dana u cas.
Shkaku i refuzimit të marrjes
Razlog odbijanja prijmea

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTUENDIM
19.11.2025

Numri i shtojcave: 2
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartëpërmendur
më (me fjalë)
Povrđujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

Shuli

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primioea ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkaku për marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ato je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpise, potpisuje ga dostaljac, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.

Fm 12/09

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebne precrati)